



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:264609
Datë: 09.02.2024
Numri i dokumentit: 05308973

AA.nr.297/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtar, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit A.M nga Vushtrria, kundër të paditurës Inspektorati i Punës në Prishtinë, me baze juridike anulim i të aktvendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, A.nr.24/2018 të datës 13.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 07.02.2024.

A K T V E N D I M

Miratohet si e bazuar ankesa e A.M nga Vushtrria, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.24/2018 i datës 13.03.2023, **anulohet**, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për vazhdim të procedurës.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.24/2018 të datës 13.03.2023, është hedhë poshtë padia e paditësit A.M nga Vushtrria, e ushtruar në këtë çështje juridike me datën 09.01.2018 e evidentuar me A.nr. 24/2018, si e parregullt.

Kundër këtij aktvendimi A.M nga Vushtrria, ka ushtruar ankesë me të cilin konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave procedura, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Në mes tjerash thekson se asnjëherë nuk ka pranuar aktvendimin për plotësimin e padisë të datës 02.03.2020 të cilit i referohet gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj. Më propozim që aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktin Administrativ

(LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 09.01.2018, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me nr.271/2017 datë 09.11.2017, të paditurës Inspektorati i Punës në Prishtinë në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit paraprak të padisë ka gjetur se padia e paditësit është jo e plotë, sepse padia e cila është ushtruar në këtë çështje juridike, nuk i është bashkangjitur kopja e aktit administrativ kontestues të kundërshtuar sipas padisë si dhe të gjitha provat të cilat i ka përshkruar në referatin e padisë, e që kanë të bëjnë me çështjen sipas padisë së tij. Prandaj gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e datës 02.03.2020, e ka detyruar paditësin që në afat prej 8 ditësh, të bëj plotësimin e padisë duke i dorëzuar Gjykatës kopjen e aktit administrativ kontestues si dhe të gjitha provat të cilat i ka përshkruar në referatin e padisë, e që kanë të bëjnë me çështjen sipas padisë së tij. Meqenëse paditësi në afatin e përcaktuar prej 8 ditësh, e as më pas, nuk i ka evituar të metat e padisë, gjykata e shkallës së parë në kuptim të Nenit 33.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) – Ligji Nr. 03/L-202, e ka hudhë padinë si të parregullt dhe ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar përfundimin e këtillë të gjykatës së shkallës së parë, dhe aktvendimin e atakuar si dhe të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar, dhe se nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës.

Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës në rastin konkret del se aktvendimin për plotësim të padisë të cilën e ka kërkuar gjykata e shkallës së parë nga ana e paditësit, nuk i është dorëzuar personalisht paditësit A.M (shih flete kthesën për nënshkrimet, ku si marrës i aktvendimit së datës 02.03.2020 është shkrimi A.M e që ky nënshkrim nuk është i njëjte me nënshkrimin e paditësit në padinë e ushtruar në këtë gjykatë si dhe me nënshkrimin në ankesë, edhe pse sipas dispozitës së nenit 110 par.1 të LPK-së, parashihet se *“Padia, përgjigja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t’i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar“*. Prandaj, për këto arsye aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika i) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së.

Po ashtu, kolegji i kësaj gjykate vëren se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore edhe të nenit 8 të LKA-së, si dhe të nenit 110 par.1 dhe nenit 7 par.3 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, për çfarë u dashtë që ky aktvendim të anulohet. Meqë nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur pa i dhënë mundësin paditësit, për qe të bëj plotësimin e padisë duke i dorëzuar Gjykatës kopjen e aktit administrativ kontestues si dhe të gjitha provat të cilat i ka përshkruar.

Mbi këto arsye, kolegji i Gjykatës së Apelit, e aprovoi ankesën si të bazuar, meqë pretendimet e paditësit se nuk ka pranuar personalisht kurrfarë shkrese për të bërë plotësimin e padisë, janë pretendime të bazuara në ligj. Andaj kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi ashtu që

Numri i lëndës: 2019:264609
Datë: 09.02.2024
Numri i dokumentit: 05308973

anuloj aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.24/2018 të datës 13.03.2023, duke ia kthyer lëndën gjykatës së njëjtë në procedim të mëtutjeshëm, për vazhdim të procedurës.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili zbatohet në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.297/2023 me datë 07.02.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi